

Çfarë duhet të dijnë prindërit dhe kujdestarët!

TRANSMETIMI - DIREKT

Live streaming përfshin transmetimin dhe shikimin e videove në internet në kohë reale, shpesh në rrjetet sociale ose përmes platformave si YouTube dhe Twitch. Shikuesit mund të ndërveprojnë përmes komenteve, bisedave dhe reagimeve gjatë transmetimit: një angazhim i tillë i menjëhershëm e bën këtë një mënyrë ngazëllyese për të shkëmbyer përvoja, për të mësuar nga të tjerët dhe për të ndërtuar komunitete dixhitale. Pavarësisht nga shumë anë pozitive, transmetimi i drejtpërdrejtë krijon gjithashtu një platformë potenciale për përmbajtje të papërshtatshme dhe paraqet disa rreziqe për fëmijët: është thelbësore të kemi parasysh privatësinë, sigurinë dhe kufizimet e moshës.

Cilat janë rreziqet?

MUNGESA VERIFIKIMIT TË MOSHËS



Pavarësisht kufizimeve të tyre të moshës, disa platforma nuk kërkojnë dëshmi të moshës për regjistrim - që do të thotë se çdokush mund të regjistrohet për një llogari (dhe potencialisht të pretendojë se është më i vjetër ose më i ri, se sa që është në të vërtetë). Në shumë raste, kjo do të thotë që transmetuesit e rinj të drejtpërdrejtë nuk mund të jenë kurrë plotësisht të sigurt se kujt po i transmetojnë dhe kush po angazhohet me transmetimin e tyre të drejtpërdrejtë.

ZBULIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Një karakteristikë e transmetimit të drejtpërdrejtë është aftësia që videot të shpërndahen menjëherë në mbarë botën. Pa aktivizuar cilësimet e sakta të privatësisë, një fëmijë mund të zbulojë pa dashje informacionin personal ose vendndodhjen e tij, duke e bërë atë të prekshëm nga bullizuesit/'grabitqarët' në internet ose vjedhjes së identitetit. Kontrolloni rregullisht cilësimet e privatësisë (dhe cilat të dhëna ndahen) në çdo aplikacion për të cilin është regjistruar fëmija juaj.

ÇDO GJË MUND TË NDODHË

Ndërsa transmetimet e videove janë drejtpërdrejt, fëmijët mund të hasin (ose ndajnë pa dashje) përmbajtje të papërshtatshme. Shumica e aplikacioneve të transmetimit të drejtpërdrejtë kanë rregulla për ta parandaluar këtë dhe të monitorojnë shërbimet e tyre, duke ofruar gjithashtu butona raporti ku përmbajtja mund të shënohet për shqyrtim (për largim). Megjithatë, mund të mos trajtohet menjëherë, që do të thotë se fëmija juaj mund të ekspozohet më tej ndaj përmbajtjeve të dëmshme gjatë një transmetimi të drejtpërdrejtë.



REGJISTRIMET E PAAUTORIZUARA



Çdo platformë e transmetimit të drejtpërdrejtë ruan videot e përfunduara për periudha të ndryshme (Për shembull, Twitch ruan transmetimet për 60 ditë, ndërsa Facebook dhe YouTube i heqin ato vetëm me kërkesë të krijuesit). Megjithatë, fshirja e një videoje nuk e ndalon gjithmonë atë që të shpërndahet: në disa raste, transmetimet janë inçizuar/regjistruar në mënyrë të paligjshme (ose pamje screenshot të marra) nga shikues të caktuar dhe të rishpërndarë në sajte të tjera.

KRIJUESIT E PËRBAJTJEVE MASHTRUESE



Fëmijët mund të shikojnë gjithashtu transmetime të drejtpërdrejtë të njerëzve të tjerë, të cilat potencialisht mund të përmbajnë çdo gjë në çdo kohë (si p.sh. lakuriqësi, përdorim droge ose sharje). Shumica e aplikacioneve pretendojnë se kontrollojnë transmetimet e drejtpërdrejtë dhe do të ndalojnë ato që nuk u përmbahen udhëzimeve të tyre - por me miliona transmetime në ditë, është e vështirë t'i rregullosh të gjitha, kështu që fëmijët mund të ekspozohen ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme, pa e ditur prindërit.

RREZIK NGA GROOMING (manipulatorë/abuzues)



Ka raportime në rritje të fëmijëve që detyrohen të kryejnë "akte sugjестive" nga të panjohur në disa aplikacione të transmetimit të drejtpërdrejtë. Për shkak të mungesës së verifikimit të kërkuar për aplikacione të caktuara, pothuajse kushdo mund të regjistrohet në këto shërbime (përfshirë në mënyrë anonime ose me një identitet të rremë). Prandaj, është jetike të siguroheni që masat e duhura të sigurisë janë vendosur përpara se fëmija juaj të fillojë transmetimin e drejtpërdrejtë.

KËSHILLË PËR PRINDËRIT & KUJDESTARËT

VENDOSE PRIVATËSINË NË RADHË TË PARË

Nëpërmjet cilësimeve të aplikacionit të transmetimit, kaloni llogarinë e fëmijës tuaj në "llogari private", në mënyrë që vetëm miqtë dhe ndjekësit të mund t'i shohin transmetimet e tyre. Ju gjithashtu mund të çaktivizoni bisedën e drejtpërdrejtë, duke e mbrojtur fëmijën tuaj nga çdo koment shqetësues - megjithëse, reagimet e shikuesve shpesh shihen si një pjesë integrale e argëtimit. Identifikoni çdo gjë afër (si uniformat e shkollës ose pikat e dukshme) që mund të tregojnë vendndodhjen e fëmijës suaj.

PËRFSHIHUNI VETË

Hulumtimet sugjerojnë se, një numër i konsiderueshëm i transmetimeve tregojnë një fëmijë vetë, shpesh në një hapësirë të supozuar të sigurt si dhoma e tyre e gjumit. Nëse fëmija juaj dëshiron të transmetojë drejtpërdrejt, pyet nëse mund të jesh i pranishëm sepse je i interesuar se si funksionon. Madje mund të konfigurosh llogarinë tënde për të marrë një njohuri më të detajuar se për çfarë flet fëmija yt në transmetimet e tij të drejtpërdrejtë - dhe kujt po transmeton.

FLISNI PËR TRANSMETIMET DIREKT

Mundohuni të filloni me anët pozitive para se të diskutoni rreziqet e mundshme. Mund të pyesni se cilat aplikacione të transmetimit të drejtpërdrejtë i pëlqen fëmija juaj dhe si i përdor ato. A shikojnë thjesht transmetime apo krijojnë të tyren? Shpjegoni pse nuk është zgjedhja e duhur të zbuloni informacione personale gjatë transmetimit (madje edhe miqve). Nëse mendoni se fëmija juaj është shumë i ri për transmetime të drejtpërdrejtë, shpjegoni atyre arsyetimin tuaj dhe ndoshta pranoni ta rishikoni këtë vendim në të ardhmen.

MENAXHO MULTI-STREAMING

Disa aplikacione dhe sajte i lejojnë përdoruesit të transmetojnë aplikacionet e tyre përmbajtje përmes platformave të shumta të mediave sociale në të njëjtën kohë. Një transmetim në SteamYard, për shembull, mund të ndahet në YouTube, Twitch, X dhe Facebook nëse llogaritë janë të lidhura. Cilësimet e privatësisë mund të ndryshojnë në secilën prej tyre, kështu që ne do të sugjerim vetëm transmetim përmes një platforme në të njëjtën kohë për të mbajtur një kontroll më të madh se kush i shikon videot e fëmijës suaj.

NË KONSIDERATË REPUTACIONIN E TYRE ONLINE

Duke qenë se transmetimet janë drejtpërdrejt, shpesh shkakton keqkuptimin tek të rinjtë se çdo gjë që ndodh në videon e tyre thjesht 'zhduket' pasi të përfundojë transmetimi. Megjithatë, videot mund të qëndrojnë në internet për një kohë të pacaktuar ose të regjistrohen nga përdorues t tjerë. Është e rëndësishme që fëmija juaj të kuptojë se çfarë bëjnë dhe thonë në një transmetim të drejtpërdrejtë, mund të dëmtojë potencialisht reputacionin e tij në internet dhe, me shumë mundësi, të shihet nga punëdhënësit e ardhshëm, kolegjet ose universitetet (që synon).

PENKOS

Parents Education Network of Kosova

Përkthim dhe përshtatje

Source: <https://www.iwf.org.uk/media/23jj3nc2/distribution-of-captures-of-live-streamed-child-sexual-abuse-final.pdf>